



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2024

Shtojca 11

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 04.12.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ALBA PALLETS & PELLETS” SHPK, me numër NIPTI L97619302U, **Adresa:** Lezhe Lac LAC Lagjja nr.6, Rruga e Patokut, Shesh i Hapur, Zk. nr.2365, me Pasuri nr.36/21.

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-27324-10-30-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje pelet për Institucionet Arsimore të Bashkisë Kurbin”.

Fondi limit: 1,791,500 (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 31.10.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.75, datë 04.11.2024.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, me numër NIPTI K01529003M.
Vlera e ofertuar: 0 (zero) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “ALBA PALLETS & PELLETS” SHPK, me numër NIPTI L97619302U.

Vlera e ofertuar: **1,590,000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, me numër NIPTI K01529003M.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit**, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....**, oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

- Operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, nuk ka paraqitur mostrat ditën e hapjes së procedurës, kriter ky i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në DST, tek pika 2.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.
- Gjithashtu sqarojmë se operatori ekonomik “SULLOLLARI-KLIMA” SHPK, në SPE nuk ka paraqitur fare formular oferte (i bie se ka ofertuar me vlerë 0 (zero) dhe dokumentacioni i tij nuk merret parasysh nga KVO për ta vlerësuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “ALBA PALLETS & PELLETS” SHPK, me adresë: Lezhe Lac LAC Lagjja nr.6, Rruga e Patokut, Shesh i Hapur, Zk. nr.2365, me Pasuri nr.36/21, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1,590,000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA